



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.292/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesat e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), paraqitur kundër subjektëve politike VAKAT dhe NISMA dega në Prizren, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuar ankesat Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS) me shenjen ZL.Anr.292/2017 e datës 21.10.2017 e parashtuar kundër subjektit politik VAKAT dega në Prizren dhe ankesa ZL.Anr.293/2017, e datës 21.10.2017, kundër subjektit politik NISMA dega në Prizren, me të cilat ka kërkuar që t'ju shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore.

A r s y e t i m

PZAP-i, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.292/2017 dhe ZL.Anr.293/2017, të datës 21.10.2017 dhe i trajton si një ankesë evidentuar me shenjen ZL.Anr.292/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të dy ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, ka pranuar dy ankesa me datë 21.10.2017 nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS) ku në ankesën ZL.Anr.292/2017 ka pretenduar se me datë 21.10.2017 kandidatja për Kuvend Komunal të Prizrenit, nga radhët e subjektit politik VAKAT, Memnuna Ajdini, ditën e heshtjes zgjedhore rreth orës 10:00 ka rishpërndarë postin e saj të mëhershëm, të datës 05.10.2017 në të cilin ka bërë thirrje për të votuar subjektin politik VAKAT dhe numrin 2 të cilin numër ajo e mban në këto zgjedhje. Ndërsa, me ankesën ZL.Anr.293/2017 ka theksuar se kandidati për Kuvend Komunal të Prizrenit, nga radhët e subjektit politik NISMA, Mentor Qenaj, ditën e heshtjes zgjedhore rreth orës 09:40 minuta ka shpërndarë postimin e tij të mëhershëm me të cilin ka bërë thirrje për të votuar subjektin politik NISMA dhe numrin 32 të cilin numër ai e mban në këto zgjedhje.

Me këtë rast, parashtruesi i ankesave ka theksuar se është shkelur neni 36 par.1 pika 6) e LPZ-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur dy fotografi në lidhje me rastet në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesave BIRN dhe Internews Kosova, lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjekteve politike VAKAT dhe NISMA, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se ankesa ZL.Anr.292/2017 është postuar me datë 05.10.2017, ndërsa ankesa ZL.Anr.293/2017 është postuar me datë 12.10.2017, që rezulton se në atë kohë ka qenë fushatë zgjedhore, e jo siç pretendohet në ankesë se postimet në fjalë janë bërë me datë 21.10.2017, sepse me dëshmitë e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk mund të identifikohet se është bërë ndonjë postim në datën që pretendohet se kanë ndodhur postimet.

Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.292/2017 më datën 22.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.